



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS

JANAR, SHKURT DHE MARS 2024



2024

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 3 MUJORIT të parë të vitit 2024

- Është përfunduar sipas ligjit të ri vlerësimi i punëtorëve gjatë kësaj periudhe, deri me 31 janar
- Ka pasur aktivitete me 3 kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore, perveq pastrimit të rrugëve nga bora, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat,
- Është bërë krasitja e drunjëve dekorativ në qytet dhe vendbanime tjera,
- Ka filluar ndërtimi i pritoreve për pritjen e udhëtarëve në qytet dhe pikat që janë përcaktuar në vendbanimet e komunës së Rahovecit,
- Po vazhdon projekti i zgjerimit të kanalizimit sipas prioriteteve,
- Po vazhdon mirëmbajtja e rrugëve në zonën urbane, në përmirësimin e ujëmbledhësve dhe gropave të krijuara në rrugë,
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e disa problemeve me ndriçim publik, poashtu ka pasur aktivitete në zgjerimin e ndriçimit publik, janë përfunduar vendbanimet Reti, Reti e Ulet, Polluzhe dhe Zatriq,
- Kemi angazhuar stafin në bashkërendimin me drejtoritë të tjera në detyrat që janë dhënë në lirin e hapësirave publike dhe inkasimin e mjeteve në shfrytëzimin e këtyre pronave,
- Është bërë marrëveshja e re me KRU Gjakovën, për investime të përbashkëta publike,
- Kemi pasur takim me donatorët për zgjerimin e kamerave që përfshin fazën e dytë të rrugës tranzite dhe fshatit Hoqë e Madhe, takime me donatorin JICA për reformat në menaxhim të mbeturinave,
- Janë përfunduar disa segmente rrugore në disa vendbanime, Gur i Kuq, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe Eperm, Ratkoc, Rahovec, Cifllak,
- Kanë filluar punimet në qytet nga kompania e kontraktuar, aktualisht punimet janë duke u zhvilluar në rrugën "Gzim Hamza-Piktori",
- Është bërë barazimi i rregullt i të hyrave në drejtori,
- Ka filluar mirëmbajtja e hapësirave publike, eliminimi i deponive ilegale, pastrimi i hapësirave publike,
- Ka filluar ndërtimi i trotareve në vendbanimet Sapniq, Drenoc, Fortese,
- Kemi filluar procedurat për instalimin e kamerave të sigurisë në qytet dhe vendet tjera ku është e nevojshme.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2024 do të jenë:

- Sfidat e drejtorisë janë kërkesat e shumëta për ndërtimin e rrugëve lokale si dhe për rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara,
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka percjellur gjatë ketyre viteve janë mbeturinat e amviserise dhe ato inerte që fatkeqsisht hidhen kudo, vend dhe pa vend ku krijohen deponie ilegale,
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës.
- Rregullimin dhe furnizim me energji elektrike, rigjenerimin e rrjetit të ri dhe kërkesa të shumeta që adresohen nga qytetaret.

Drejtori i DSHP-së

Përparim Krasniqi